



Edhe pse Vllaznia kishte bere kerkese qe te mos drejtohej ndeshja ndaj Lacin nga gjyqtari Kridens Meta, FSHF-ja si gjithnje beri nje vesh shurdhe e nje sy qor duke shkaktuar tension perpara (filloi me 10 minuta vonese) dhe gjate ndeshjes . "Në futboll ndodh gjithçka e ndodh që të humbësh edhe me këtë rezultat. Ishim nën presionin e gjyqtarëve, pasi e shoh krejtësisht të paarsyeshme që të vendoset për këtë ndeshje një arbitër për të cilin ne si klub kemi kërkuar që të mos na arbitrojë. Në pjesën e parë të lojës kundërshtari ka marrë 8 faulle në afërsi të zonës, dy prej të cilave I shndërroi në gol, sigurisht për meritë të tyre. Skuadra nuk reagoi dot dhe kjo u pa qartë. Pasi rezultati shkoi nga 2-0 në 3-0 pothuajse gjithçka përfundoi. Gjithashtu arbitri lejoi lojën e rëndë që nuk I shkon për shtat ekipit tonë, e nuk e përballuam dot. Pra ishim nën presion psikologjik që në fillim të ndeshjes", përfundoi Canaj bisedën e tij pas ndeshjes per mediat